



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR EMËRIMIN E KRYETARËVE DHE ZËVENDËSKRYETARËVE TË KZAZ-VE, PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 23.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	Bitri-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për emërimin e Kryetarëve dhe Zëvendëskryetarëve të KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23 pika 1, gërma a, neni 29, pika 2, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi vendimet e KZAZ-ve, si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 114, datë 02.04.2019, ka emëruar anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Demokratike dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, parti e parë dhe e dytë e opozitës parlamentare, nuk kanë paraqitur propozimet për anëtarë të KZAZ-ve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 29, pika 5, të Kodit Zgjedhor, Udhëzimit nr.2, datë 25.02.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar, me vendimin nr.141, datë 09.04.2019, dhe vendimin nr.173 datë 16.04.2019 plotësoi vakancat në të 90 KZAZ-të, duke



emëruar kryesisht anëtarin e katërt në KZAZ me numër tek, dhe sekretarët në KZAZ-të me numër çift.

Kodi Zgjedhor, në nenin 29, pika 2, përcakton procedurën për zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të KZAZ-së. KZAZ-të, në mbledhjen e parë, thirrur me vendimin e KQZ nr. 142, datë 09.04.2019, dhe vendimin nr. 173, datë 16.04.2019, kanë marrë vendim dhe i propozojnë KQZ të emërojë Kryetarin në KZAZ me numër çift, dhe Zëvendëskryetarin në KZAZ me numër tek.

KQZ konstaton se propozimet e paraqitura nga KZAZ janë në përputhje me kërkesat e nenit 29 pika 2, të Kodit Zgjedhor,

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 29 pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të emërojë Kryetarët dhe Zëvendëskryetarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

